



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM  
KUKËS

Nr. 877 Prot

Kukës, më 10.10.2023.

V E N D I M  
Nr. 144, datë 10.10.2023

KËSHILLI I GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË  
PËRGJITHSHËM  
KUKËS

EMËRIM NË DETYRË TË Znj. Esmeralda GECA  
ME PROCEDURËN NGRITJE NË DETYRË NË KATEGORINË DREJTUESE “Shef  
sektori i Protokollit, Arkivës dhe Kordinimit të Zyrave të Shërbimit”

Në mbështetje të nenit 54, 55, 56/7, 57, 58, 60, 62, të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit nr.622, datë 10.12.2020, “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Vendimit nr. 78, datë 18.07.2023 të Këshillit të Gjykatës, shpallja për vendet e lira me nr.713 prot datë 06.09.2023 të Këshillit të Gjykatës, Vlerësimi dhe testimi i kandidates Znj.Esmeralda Geca datë 05.10.2023, njoftimi mbi rezultatet e procedurës së “NGRITJES NË DETYRË” me shkresën nr. 713/2 prot datë 05.10.2023, Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, në përfundimin e procedurës “NGRITJES NË DETYRË”, për kategorinë drejtuese, në pozicionin “Shef sektori, i Protokollit, Arkivës dhe Kordinimit të Zyrave të Shërbimit”,

V E N D O S I

1. Emërimin në detyrë të **Znj.Esmeralda Geca** për kategorinë drejtuese, në pozicionin “Shef sektori, i Protokollit, Arkivës dhe Kordinimit të Zyrave të Shërbimit”,.
2. Marëdhëniet e punës dhe ato financiare në pozicionin “Shef sektori, i Protokollit, Arkivës dhe Kordinimit të Zyrave të Shërbimit”,fillojnë me datën 10.10.2023.
3. Për komunikimin e këtij vendimi Znj.Esmeralda Geca, ngarkohet Kancelari i Gjykatës Z.Shkelzen Mulosmani .
4. Për zbatim e këtij vendimi ngarkohet shefi i sektorit të financës dhe buxhetit Znj.Rajmonda Korbi, dhe sektori i IT-së.
5. Nje kopje e ketij vendimi te behet pjese e urdherave të brendshëm të vitit 2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI I GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË  
PËRGJITHSHËM KUKËS

ANËTAR  
KANCELARI

Shkelzen MULOSMANI

KRYETAR  
GJYQTAR

Merita KARAJ

ANËTAR  
GJYQTAR

Aulon PASHAJ

